
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____ 2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

[Data 29.05.2026]

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

E v i t a SHPK me Nipt L31714005J

Adresa: Tirane, Rruga “Sami Frasheri”, Nr.4, KatV, Nr. Pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270,
Vol. 28, faqe 155, Tirane-1001

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-82303-04-16-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Objekti “Blerje materiale specifike, Impiant Koklear për nevoja të QSUNT, për 24 muaj”, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me fondi limit total i marrëveshjes kuadër është 122,550,000 (njëqind e njëzet e dy milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. Afati i marrëveshjes kuadër është 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 17.04.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 28 datë 20 Prill 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. E v i t a SHPK

Nipt L31714005J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 111,843,000 (njëqind e njëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzetë e tre mijë) lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. FEDOS SHPK

Nipt K01514009I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 90,300,000 (nëntëdhjetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. FEDOS SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

Nipt K01514009I

Numri i NIPT-it

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit:

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë ofertues për procedurën e sipercituar, rezultoi se:

➤ S'kualifikohet operatori ekonomik si më poshtë:

Operatori Ekonomik "FEDOS" shpk, pasi me dokumentacionin ligjor të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

a) Operatori ekonomik "FEDOS" sh.p.k., nuk plotëson kërkesat e Seksionit I: Udhëzime për Operatorët ekonomikë, B. Përgatitja e ofertave, pika 6, "Çmimet" ku citohet se:

- Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

- Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasi të dhe çmimin e tyre.

- Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

- Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

- Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

Bazuar në Shtojcën 6 "Formulari i specifikimeve teknike" është kerkuar:

Nr.	Emërtim	Specifikime Teknike
		Trashësia e pjesës së rendëshme të sistemit të implantit koklear duhet të jetë jo më shumë se 6 mm.

1	Implant koklear (CI)	<p>Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë se 1.8 mm.</p> <p>Implanti duhet të ketë jo më pak se 12 elektroda aktive.</p> <p>Rezistenca ndaj goditjes së implantit duhet të jetë jo më pak se 2.5 J.</p> <p>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kycit të nofullës ose syzeve)</p> <p>Duhet të ofrohen disa nivele fortësie magneti.</p> <p>Procesori duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji duke permbushur certifikimet IP 68 (ëaterproof)</p> <p>Implanti koklear duhet të jetë i pajisur me telekomandë për procesorin e zërit.</p> <p>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</p> <p>Numri i burimeve të implantit duhet të jetë i barabartë ose më i madh se numri i kanaleve reale.</p> <p>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion të ndryshimit automatik të programit, pa pasur nevojë të rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual)</p> <p>Implanti duhet të jetë me këllëf titani.</p> <p>Operatori ekonomik ofertues duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar.</p> <p>Mundësi për të realizuar Rezonancë Manjetike deri në 3 T pa patur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</p> <p>Mundësia e heqjes së parakohëshme të magnetit nga marrësi / Stimuluesi për të realizuar një Rezonancë Manjetike (MRI) të kokës.</p> <p>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</p> <p>Mundësia e sigurimit të një Procesori BTE me një aparat dëgjimi të përfshirë për stimulimin elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</p> <p>Implanti duhet të ofrojë stimulim të paktën dy kanaleve.</p> <p>Implanti duhet të jetë në gjëndje të sigurojë një minimum prej 40000 pps (impulse për sekondë) pa ndonjë kufizim softëare.</p> <p>Secili prej kanaleve të elektrodës duhet të jet me një kondesator të pavarur të sigurisë.</p> <p>Procesori të ofrojë mundësinë e lidhjes wireless me telefonin apo pajisje të tjera të cilat janë të pajisura me bluetooth</p> <p>Procesori i zërit duhet të jetë i pajisur me një dritë për të treguar nëse është i lidhur me implantin</p> <p>Procesori i zërit BTE të mund të kontrollohet përmes një aplikacioni në telefon.</p> <p>Procesori të jetë i pajisur me bateri të rikarikueshme</p>
---	-----------------------------	--

		Jetëgjatësia e baterisë së rikarikueshme duhet të jetë të paktën 15 orë. Materiali mjekësor dhe softëare duhet të kenë certifikatë konformiteti CE ose FDA.
--	--	---

Referuar specifikimeve teknike, rezulton se, Implanti Koklear përbën një pajisje mjekësore komplekse, e cila klasifikohet në kategorinë specifike të pajisjeve mjekësore të implantueshme aktive, së bashku me komponentët dhe pjesët përbërëse që sigurojnë funksionimin e tij.

Në këtë kuadër, bazuar në Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 51, germa “b”, përcakton shprehimisht se përjashtohen nga TVSH-ja furnizimet me interes të përgjithshëm, ku përfshihet:

“furnizimi i barnave, pajisjeve mjekësore të implantueshme aktive dhe pajisjeve mjekësore të implantueshme”.

Gjithashtu Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar pajisjet mjekësore që përfitojnë përjashtim nga TVSH-ja.

Konkretisht, në nenin 38 të këtij udhëzimi “*Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore*”, parashikohet se pajisjet mjekësore të impantueshme dhe pajisjet mjekësore të impantueshme aktive të përjashtuara nga TVSH-ja, janë si më poshtë:

- Implanti Koklear, me kod NMK 90214000100

Po ashtu, bazuar në “Nomenklaturën e kombinuar të mallrave” të publikuar nga “Administrata Doganore Shqiptare” në <https://www.dogana.gov.al/dokument/6715/nomenklatura-2026> , faqe 631, rezulton se artikulli me Kod NK 9021 40 00 – Mjete ndihmese te degjimit, **perjashto pjeset dhe plotesuesit** nuk parashikon tarifa doganore.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton qartë se përjashtimi nga TVSH-ja lidhet vetëm me implantin koklear, pra komponentin implantues që vendoset në koklea, dhe jo me pajisjet apo aksesoret përbërës të sistemit. Për rrjedhojë, pjesë të tilla si mikrofonët, magnetët, pajisjet e komandimit në distancë, procesorët e zërit apo aksesorë të tjerë ndihmës nuk rezultojnë të jenë të pajisur me kode doganore të përjashtuara nga TVSH-ja dhe, si të tilla, i nënshtrohen regjimit normal të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Në këto kushte, rezulton se vetëm implanti koklear përfiton përjashtim nga TVSH-ja, ndërsa për pjesët e tjera përbërëse duhet të përlllogaritet dhe deklarohet vlera përkatëse e TVSH-së, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

Nga shqyrtimi i Shtojcës 3, të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k., rezulton se është deklaruar çmimi njësi pa TVSH, ndërkohë që në formularin e ofertës është pasqyruar vlera e TVSH-së “0 lekë”. Ky deklarim bie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe fiskale në fuqi, pasi, siç u analizua më sipër, i vetmi kod NMK që përfiton përjashtim nga TVSH-ja është kodi 90214000100, i cili i referohet implantit koklear. Për pjesët e tjera përbërëse të sistemit koklear, TVSH-ja është e aplikueshme dhe duhet të deklarohet në formularin e ofertës ekonomike.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. duhet të kishte përfshirë dhe deklaruar vlerën e TVSH-së për komponentët përbërës të implantit koklear që nuk përfitojnë përjashtim ligjor.

Akoma me tej, neni 24 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcakton se:

“Gjatë përgatitjes së ofertave, kandidatët ose ofertuesit duhet të përfshijnë të gjitha detyrimet fiskale, që janë në fuqi deri në 28 (njëzet e tetë) ditë para hapjes së ofertave, me përjashtim të TVSH-së, e cila, nëse është e aplikueshme, do të llogaritet mbi vlerën e ofertës.”

Kjo dispozitë ngarkon operatorin ekonomik me detyrimin për të evidentuar dhe përlogaritur saktë të gjitha detyrimet fiskale të aplikueshme. Për rrjedhojë, mosdeklarimi i TVSH-së për komponentët që nuk përjashtohen nga ligji sjell si pasojë paraqitjen e një oferte ekonomike në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe të dokumenteve të tenderit. Një situatë e tillë krijon gjithashtu rrezik të drejtpërdrejtë gjatë fazës së zbatimit të kontratës, pasi mund të sjellë pamundësi për realizimin e saj sipas vlerës së ofertuar apo mosmarrëveshje kontraktore.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “FEDOS” sh.p.k

b) Operatori ekonomik me dokumentacionin ligjor të paraqitur në SPE nuk plotëson kriterin 2.3.5 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT, në të cilin kërkohet si më poshtë:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për mallin objekt prokurimi, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog/skedë duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mallit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”

Në Shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” është kërkuar:

Nr.	Emërtim	Specifikime Teknike
1	Implant koklear (CI)	<p>Trashësia e pjesës së rendëshme të sistemit të implantit koklear duhet të jetë jo më shumë se 6 mm.</p> <p>Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë se 1.8 mm.</p> <p>Implanti duhet të ketë jo më pak se 12 elektroda aktive.</p> <p>Rezistenca ndaj goditjes së implantit duhet të jetë jo më pak se 2.5 J.</p> <p>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kycit të nofullës ose syzeve)</p> <p>Duhet të ofrohen disa nivele fortësie magneti.</p> <p>Procesori duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji duke permbushur certifikimet IP 68 (ëaterproof)</p> <p>Implanti koklear duhet të jetë i pajisur me telekomandë për procesorin e zërit.</p> <p>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</p> <p>Numri i burimeve të implantit duhet të jetë i barabartë ose më i madh se numri i kanaleve reale.</p> <p>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion të ndryshimit automatik të programit, pa pasur nevojë të rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual)</p> <p>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi.</p> <p>Operatori ekonomik ofertues duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar.</p>

		<p>Mundësi për të realizuar Rezonancë Manjetike deri në 3 T pa patur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</p> <p>Mundësia e heqjes së parakohëshme të magnetit nga marrësi / Stimuluesi për të realizuar një Rezonancë Manjetike (MRI) të kokës.</p> <p>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</p> <p>Mundësia e sigurimit të një Procesori BTE me një aparat dëgjimi të përfshirë për stimulimin elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</p> <p>Implanti duhet të ofrojë stimulim të paktën dy kanaleve.</p> <p>Implanti duhet të jetë në gjëndje të sigurojë një minimum prej 40000 pps (impulse për sekondë) pa ndonjë kufizim softëare.</p> <p>Secili prej kanaleve të elektrodës duhet të jetë me një kondesator të pavarur të sigurisë.</p> <p>Procesori të ofrojë mundësinë e lidhjes ëireless me telefonin apo pajisje të tjera të cilat janë të pajisura me bluetooth</p> <p>Procesori i zërit duhet të jetë i pajisur me një dritë për të treguar nëse është i lidhur me implantin</p> <p>Procesori i zërit BTE të mund të kontrollohet përmes një aplikacioni në telefon.</p> <p>Procesori të jetë i pajisur me bateri të rikarikueshme</p> <p>Jetëgjatësia e baterisë së rikarikueshme duhet të jetë të paktën 15 orë.</p> <p>Materiali mjekësor dhe softëare duhet të kenë certifikatë konformiteti CE ose FDA.</p>
--	--	--

Per permbushjen e ketij kriteri, operatori ekonomik “FEDOS” shpk ka dorezuar ne SPE dokumentacionin:

- Katalog.pdf, 20 faqe;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se pajisja e ofertuar nuk përmbush një nga specifikimet të përcaktuara në DST, konkretisht kërkesën:

“Implanti duhet të jetë në gjëndje të sigurojë një minimum prej 40000 pps (impulse për sekondë) pa ndonjë kufizim software”.

Nga dokumentacioni teknik i prodhuesit “.....”, konkretisht në materialin shpjegues të produktit te ofertuar rezulton se impianti i ofertuar siguron një “Total Stimulation Rate (TSR)” prej vetëm 15,648 pps. Në dokumentin teknik prodhuesi deklaron shprehimisht: “....implant system provides a clinically available TSR of 15,648 pps.”

Sa më sipër provohet se kapaciteti maksimal i stimulimit të implantit të ofertuar është ndjeshëm më i ulët se minimumi prej 40,000 pps i kërkuar në DST.

Argumentimi i operatorit ekonomik/prodhuesit lidhur me “non-inferiority” klinike të një niveli më të ulët stimulimi nuk mund të merret në konsideratë për të tejkaluar një kërkesë teknike minimale të përcaktuar shprehimisht në DST, pasi autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ekuivalencë funksionale apo performancë klinike të ngjashme, por ka përcaktuar një parametër teknik numerik minimal të detyrueshëm.

Në kushtet kur dokumentacioni teknik i ofertës provon një vlerë maksimale prej vetëm 15,648 pps, ndërkohë që DST kërkon minimumi 40,000 pps, oferta rezulton në mospërputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

KVO gjykon se janë operatorët ekonomikë ofertues të cilët marrin përsipër përbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave të ofertuara prej tyre me ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik nuk ka arritur të provojë që përbush kërkesat e kualifikimit në pikën 2.3.5 të dokumentave të tenderit.

Bazuar në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “FEDOS” sh.p.k

c). Operatori ekonomik me dokumentacionin ligjor të paraqitur në SPE nuk plotëson kriterin 2.2.2 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, në të cilin kërkohet si më poshtë:

“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Per përbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik “FEDOS” shpk ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Bilanci_2023
- Bilanci_2024
- Bilanci_2025

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka përbushur kriterin e përcaktuar në DST lidhur me paraqitjen e bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të konfirmuara nga autoritetet tatimore, pasi bilanci i vitit 2025 i paraqitur prej tij rezulton i pakonfirmuar nga organet tatimore. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe nuk provon përbushjen e kapacitetit ekonomik dhe financiar sipas formës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. E v i t a SHPK

Nipt L31714005J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 111,843,000 (njëqind e njëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzetë e tre mijë) lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR